

Të organizojmë shkollën së bashku

Informacione për prindërit në zbatim të ligjit të ri
për shkollën fillore



Të nderuar prindër



Shkolla fillore rikujton historinë e saj të gjatë dhe të suksesshme dhe feston këtë vit 175-vjet- jubileum. Që nga ekzistenca e saj, ajo ka kontribuar vendosshëm në zhvillimin pozitiv të kantonit të Cyrihut si dhe në një bashkëjetesë me respekt të plotë. Ajo është shtylla kryesore për të gjitha nivelet tjera arsimore, ndaj kualiteti i saj është i një rëndësie krejtësisht të veçantë. Ne kemi sot një shkollë të mirë-dhe festojmë me gëzim pse jo edhe me pak krenari për të arriturën, ditëlindjen e saj.

Në mënyrë që, shkolla fillore të mund ti përgjigjet nevojave shoqërore edhe në të ardhmen, duhet që ajo të ndryshojë vazhdimisht.

Me ligjin e ri për shkollën fillore mund të reagoget ndaj shumë kërkesave të reja. Qëllimi është dhe mbetet një «shkollë fillore për të gjithë».

Më 5. Qershor 2005 një shumicë e madhe e popullatës votuese të Cyrihut i tha Po ligjit të ri për shkollën fillore. Kjo votë e kuptueshme

është një porosi e qartë, që risitë të trajtohen dhe zbatohen me kujdes, në mënyrë të shpejtë dhe konsekuente.

Me ligjin e ri për shkollën fillore mund të reagoget ndaj shumë kërkesave të reja. Qëllimi është dhe mbetet një një «shkollë fillore për të gjithë», e cila të garantojë barazi shansesh, një kualitet të lartë mësimi dhe kushte të mira për gjithë nxënësit dhe mësuesit.

Shkolla fillore merr me ligjin e ri një bazament të qëndrueshëm, mbi të cilin ajo mund të zhvillohet më tej pa e humbur atë që ajo ka akumuluar dhe ruajtur. Që të arrihen këto qëllime, nevojitet bashkëpunimi i gjithë të përfshirëve.

Kam kënaqësinë, që si drejtoreshë e arsimit të lejojem të shoqëroj këtë hap të rëndësishëm. Edhe Ju si prindër do ti përjetoni ndryshimet në shkollën fillore nëpërmjet fëmijëve tuaj.

Me këtë broshurë ne ju informojmë Ju me të rejat më të rëndësishme drejt zbatimit të ligjit për shkollën fillore.

Unë ju uroj nxënëseve dhe nxënësve, prindërve dhe gjithë personave të përfshirë në shkollë për përkushtimin e tyre, shumë sukses dhe arritje.

Këshilltare ministrie Regine Aepli
Drejtoreshë arsimore

Kjo broshurë ju informon mbi të rejat më të rëndësishme të ligjit mbi shkollën fillore që lidhen me prindërit.

Komunat kanë tashmë një zonë veprimi në shumë fusha.

Të tjera informacione për zbatimin e ligjit të shkollës fillore Ju do ti gjeni në adresën:

 www.volksschulgesetz.ch

 **Prindërit**

 **Zbatimi i ligjit të ri për shkollën fillore**

BOTIMI

PUBLIKUESE:

Drejtorja arsimore e kantonit të Cyrihut, Zyra për shkollën fillore (Volksschulamt) Walchestrasse 21, 8090 Zürich
www.volksschulamt.ch
© Bildungsdirektion Kanton Zürich
Botimi 1-rë, Korrik 2007

Design: raschlepartner.ch

Të organizojmë shkollën së bashku

Me ligjin e ri për shkollën fillore do të ruhet ajo çka është arritur dhe vlerësuar si dhe do të futen tashmë risitë e provuara në të gjithë kantonin.

Shkolla jonë fillore përbën bazën e gjithë arsimimit. Me ligjin e ri për shkollën fillore shkolla në kantonin e Cyrihut do të ndryshojë. Parimet mbështetëse të shkollës fillore nuk do të ndryshojnë. Ato zënë edhe në ligjin e ri për shkollën fillore një vend kryesor.

Ashtu si më përpara fëmijët dhe të rinjtë do të përkrahen në tërësi, ku shkolla në linjë të parë ka detyra shkollimi, ndërsa edukimi mbetet përgjegjësi e prindërve

Në § 2 të ligjit për shkollën fillore përmbahen detyrat e arsimit dhe edukimit:

- 1 Shkolla fillore edukon në një sjellje të orientuar në vlerat kristiane, humaniste dhe demokratike. Megjithatë ajo ruan lirinë e besimit dhe ndërgjegjjes si dhe merr në konsideratë pakicat. Ajo përkrah njësoj si djemtë dhe vajzat.
 - 2 Shkolla fillore plotëson edukimin në familje. Organet shkollore, personeli mësimdhënës, prindërit dhe sipas nevojës edhe organet përkatëse në ndihmë të të rinjve punojnë së bashku.
 - 3 Shkolla fillore përmbush detyrën e saj arsimore nëpërmjet organizimit të mësimimit dhe bashkëjetesës në shkollë.
 - 4 Shkolla fillore përçon njohuri bazë dhe aftësi; ajo çon në njohjen e rrethanave. Ajo përkrah respektin para bashkëqytetarëve dhe mjedisit dhe vë si qëllim zhvillimin e plotë të fëmijëve në njerëz me aftësi të pavarura dhe shoqërore. Shkolla fillore përpiqet të zgjojë dhe të ruajë kënaqësinë në mësim dhe rezultate. Ajo përkrah veçanërisht ndjenjën për marrë përgjegjësi, për të qënë aspirues, për të arritur pasuri gjyquese dhe kritike si dhe aftësinë për dialogim.
- Përgjatë mësimimit merren në konsideratë aftësitë individuale dhe prirjet e fëmijëve dhe krijohet baza e të mësuarit afatgjatë.**

TË REJAT MË TË RËNDËSISHME:

- Ligji për shkollën fillore përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet e prindërve, nxënëseve dhe nxënësve.
- Ligji për shkollën fillore bazohet në përgjegjësinë e përbashkët të prindërve, nxënëseve dhe nxënësve si dhe personelit mësimdhënës. Ai parashikon për këtë arsye edhe të drejta bashkërenduese të ndryshme për nxënëset, nxënësit dhe prindërit.
- Duke qënë se shkollat drejtohen, ato përmbajnë me këtë edhe elementin thelbësor të ligjit për shkollat fillore, pasi shkollat përfitojnë më tepër liri organizimi dhe mund të reagojnë shpejt ndaj nevojave lokale dhe dëshirave të nxënëseve, nxënësve dhe prindërve. Mësuesët përkrahen në punën e tyre nga drejtues shkollorë, kështu edhe prindërit kanë përveç personelit mësimdhënës të fëmijëve të tyre një tjetër person kontakti.
- Kopshti i fëmijëve bëhet sipas ligjit të ri pjesë e shkollës fillore dhe i detyruar. Detyrimi shkollor si rrjedhojë ngrihet nga 9 në 11 vjet.
- Niveli dytësor arsimor organizohet më fleksibël. Në vend të dy niveleve të deritanishme «nivel dytësor klasifikuar» (Gegliederte Sekundarstufe) «niveli dytësor i trepjeshëm» (Dreiteilige Sekundarstufe) mund të zgjidhen variante të ndryshme.
- Ndryshimet shoqërore në fushën e strukturave familjare do merren parasysh me anë të futjes së orëve bllok në të gjitha lëndët përgjatë paraditeve dhe nga ana tjetër me detyrimin e komunave për të ofruar struktura ditore të mëtejshme.
- Ligji i ri për shkollën fillore vë theksin dukshëm në fushën e integracionit: që nxënëset dhe nxënësit me probleme për të mësuar por gjithashtu edhe nxënëset dhe nxënësit e talentuar që të përkrahen sa më shumë që është e mundur brenda regullave klasore.

→ Të gjitha shkollat që kanë një përqindje të lartë fëmijësh me gjuhë të huaja, marrin mbështetje shtesë të specializuar dhe financiare.

→ Instrumente të reja për sigurimin e kualitetit dhe zhvillimit garantojnë një arsimim të barasvlershëm dhe të mirë në mbarë Kantonin.

Ligji për shkollën fillore është një investim në një shkollë të hapur, të larmishme dhe rentabël për të gjithë. Ai garanton përshtatjet e mundshme në rrethanat e reja shkollore dhe shoqërore. Ligji i ri siguron barazinë e shanseve dhe jep një kontribut të rëndësishëm në lidhjen e brendshme sociale.

FREKUENTIMI/NDJEKJA I/E SHKOLLËS ËSHTË PA PAGESË

Të gjithë fëmijët, të cilët deri më 30. Prill të një viti kanë mbushur 4-vjeç, bëhet për ta fillimi i vitit tjetër shkollor i detyrueshëm. Pretendimi për një frekuentim shkollor pa pagesë vlen për zonën e banimit. Nëse vendqëndrimi ditor i fëmijës nuk i përket zonës së banimit (për shembull qëndrimi tek prindërit përkujdesës), atëherë kanë prindërit të njëjtin pretendim si për vendqëndrimin ditor.

Nëse rrethanat e vendit nuk janë të përshtatshme siç janë gjatësia ose rrezikshmëria e rrugës për në shkollë, atëherë fëmijët mund t'ju ndahen një komune tjetër. Në përgjithësi kësaj rregullimesh arrihen me marrëveshje ndërmjet komunave.

Prindërit kanë mundësinë – në rastin kur jepen arësye të pranueshme – të paraqesin një kërkesë tek këshilli ndërmjetësues i shkollës (Schulpflege) për një caktim në një tjetër komunë. Komuna përkatëse vendos për një kërkesë të tillë dhe përcakton koston shkollore. Nëse nuk mund të pretendohet frekuentimi i shkollës nga fëmija në komunën ku bën pjesë, atëherë edhe pagesa shkollore duhet të mbu-

lohet nga komuna prej së cilës fëmija largohet. Në rast se shkaqet e mosfrekuentimit shkollor kanë të bëjnë me vetë fëmijën apo prindërit, atëherë këto të fundit mund të detyrohen të marrin përsipër pagesën shkollore.

PRINDËRIT KANË TË DREJTA DHE DETYRA

Ligji për shkollën fillore fikson qartë disa të drejta dhe detyra për prindërit.

Aty ndryshojnë nga njëra-tjetra fushat e informacionit, bashkëveprimit dhe detyrave.

SHKOLLA, TË DREJTAT DHE DETYRAT

Prindërit kanë të drejtën e tyre që të informohen në kohë nga shkolla për rëndësitë shkollore dhe organizative (ndarja në një shkollë/klasë, vendi i zhvillimit të mësimi dhe orët e mësimi.) E njëjta gjë vlen edhe për ngjarjet shkollore (ngjarje të shënuara, ditë vizitash etj.). Shfaqen tek një nxënëse apo nxënës vështirësi, zhvillohen ndodhi të pazakonta apo konstatohen zhvillime të jashtëzakonshme në arritje dhe sjellje, ekziston si rrjedhojë një detyrim informimi ndërmjet mësuesve dhe prindërve.

Prindërve u mundësohen në ligj edhe të drejtat e bashkëveprimit. Në këto bëjnë pjesë edhe të drejtat individuale të bashkëpunimit në aspektin e vendimit për përparimin shkollor (shiko «vlerësim dhe promovim»), udhëzimit, ndryshimit apo shfuqizimit të masave të veçanta pedagogjike dhe masave disiplinare të parashikuara në ligj.

Tek udhëzimet e natyrës organizative siç është ndarja në një shkollë apo klasë, tek udhëzimet në të përditëshmen shkollore, në dhënien e notave dhe vlerësimin e nxënësit nuk ekziston një e drejtë bashkëpunimi. Për vendime me domosdoshmëri bashkëveprimi, duhet të shkëmbehen informacione të rëndësishme.

Në rastin kur me një nxënëse ose nxënës ka probleme, prindërit kanë të drejtën por edhe obligimin të marrin pjesë në bisedime. Drejtorja e shkollës mund ti bëjë në disa raste aktivitete të obligueshme, nëse është e nevojshme pjesëmarrja e të gjithë prindërve.

Në statutin organizativ të komunitetit shkollor duhen të fiksohen/qëndrojnë edhe të drejtat e përgjithshme të bashkëpunimit. Në ligjin për shkollën fillore qëndron që prindërve ose përfaqësuesve të tyre u mundësohet dëgjimi në përpunimin e programit shkollor, por ato nuk mund të detyrohen për një bashkëpunim të përgjithshëm.

Në rregulloren për shkollën fillore ekzistojnë përveç kësaj edhe obligime shtesë. Prindërit janë përgjegjës që nxënëset dhe nxënësit

- Të frekuentojnë rregullisht mësimin dhe të jenë të ngopur me gjumë
- të jenë të veshur dhe mbathur siç duhet për mësim ose për raste të veçanta si udhëtimet shkollore ose ekskursionet;
- të mund të kryejnë detyrat e shtëpisë në kushte të mira (vend i përshtatshëm mësimi, qetësi etj.).

Përveç kësaj është e rëndësishme, që përgjegjësia ti mbetet prindërve për nxënëset dhe nxënësit, gjatë rrugës së tyre për në shkollë.

Ai që shkel qëllimisht detyrimet prindërore të përmbledhura në ligj, mund të dënohet me porosi të këshillit ndërmjetësues të shkollës nga zyra mbikqyrëse (Statthalteramt) e kantonit me një gjobë deri në 5000 franga.

NXËNËSET DHE NXËNËSIT MBAJNË BASHKËPËRGJEGJËSI

Në rradhë të parë funksionimi i shkollës orientohet në të mirë të nxënësve dhe nxënësve, por nga këta të fundit kërkohet që ata të përmbushin detyrimet e tyre dhe të marrin pjesë aktiv në funksionimin e shkollës.

Ashtu si prindërve u mundësohen edhe nxënësve disa të drejta bashkëpunimi. Ato marrin pjesë në vendime në përshtatje të moshës dhe aftësive të tyre. Në statutin organizativ dhe programin shkollor përcaktohet një bashkëpërgjegjësi dhe bashkëvendosje në përputhje me nivelin zhvillimor të fëmijëve.

MASAT DISIPLINORE

Mësuesit bëjnë të mundur që drejtorja e shkollës të urdhërojë masa të ndryshme, nëse problemet disiplinore nuk mund të zgjidhen direkt në klasë. Këtu bëjnë pjesë paralajmërimi me gojë, ai me shkrim ose edhe zhvendosje në një klasë tjetër. Masa të mëtejshme si: udhëzuesi për mësimin fakultativ, udhëzuesi i përkohshëm për mësimin e detyrueshëm deri në katër javë, zhvendosja në një shkollë tjetër ose lirimi nga shkolla e detyrueshme në vitin e fundit shkollor mund të urdhërohen vetëm nga këshilli ndërmjetësues i shkollës. Për masa të tilla duhet të informohen prindërit që më përpara.

Nëse me sjelljen e një nxënëseje apo nxënësi rrezikohen të tjerët apo prishet funksionimi i shkollës në mënyrë të dukshme, atëherë këshilli ndërmjetësues i shkollës vendos për një shkollë të veçantë.

Nëse prindërit nuk pajtohen me masat të tilla, duhet që organet shkollore të informojnë organet e posaçme në mbrojtje të fëmijëve. Nëse rrezikohet e mira e nxënësve, mësuesët dhe këshilli ndërmjetësues i shkollës janë të detyruar të deklarojnë në organin e sipërpërmendur.

Në rregulloren e ligjit për arsimin fillor janë përmbajtur edhe disa rregulla sjelljeje për nxënëset dhe nxënësit:

- 1 Nxënëset dhe nxënësit tregojnë respekt para mësuesve dhe personave tjerë që punojnë në shkollë. Ata duhet të ndjekin udhëzimet e mësuesve dhe të lënë atë çka mund të dëmtojë fizikisht dhe psikikisht veten dhe personat tjerë. Të sillen me kujdes me pajisjet dhe materialet.**
- 2 Nxënësve dhe nxënësve u ndalohe**
 - a) të sjellin me vete dhe të konsumojnë alkool, duhan dhe drogat e tjera në ambientet dhe ngjarjet shkollore**
 - b) të sjellin me vete armë dhe imitacione të tyre në ambientet dhe ngjarjet shkollore .**
- 3 Ndalimi i konsumimit sipas paragrafit të 2-të lit. a vlen që nga fillimi e deri në mbarim të orëve të mësimit -bashkë me pushimet si dhe ngjarjet shkollore-edhe jashtë ambienteve jashtëshkollore.**
- 4 Drejtorja e shkollës dhe mësuesit mund t'ju ndalojnë nxënësve dhe nxënësve të sjellin me vete mjete të tjera të rrezikshme në ambientet dhe ngjarjet shkollore.**

Sendet të rrezikshme janë ato, të cilat janë të përshtatshme të rrezikojnë dhe të frikësojnë persona.
- 5 Drejtorja e shkollës dhe mësuesit ua marrin këto sende sipas paragrafit 2 dhe 4. Ata vënë në dijeni nëse është e nevojshme edhe prindërit.**

Ndryshimet në organizimin e shkollës

Me ndryshimet shoqerore duhet te ecin paralelisht edhe drejtimi i shkolles, integrimi dhe ofertat e kujdestarise

SHKOLLA E UDHËHEQUR- MË SHUMË LIRI ORGANIZIMI

Një risi themelore dhe tashmë e provuar në shumë komuna është futja e shkollave të udhëhequra. Bashkëpunimi i gjithë të përfshirëve në «Team»/grup është një tipar thelbësor i shkollave të udhëhequra: Nëse të gjithë bashkëpunojnë për një gjë, atëherë përmirësohet kualiteti i shkollës si në aspektin pedagogjik dhe në atë organizativ.

Prindërit kanë në udhëheqjen shkollore një person kontakti për çdo pyetje, të cilat kanë të bëjnë në përgjithësi me shkollën dhe/ose që nuk mund të bisedohen me mësuesin e fëmijës. Sipas nevojës mund të shtjellohen çështjet që i përkasin fëmijës së bashku në mes të prindërve, mësuesve dhe udhëheqësve të shkollës.

Udhëheqja e shkollës drejton shkollën në punët funksionale dhe është së bashku me konferencën shkollore- kolegjumit e gjithë mësuesve të një shkolle- përgjegjëse për çështjet pedagogjike. Për këtë shkolla mund dhe duhet të reagojë ndaj nevojave lokale dhe specifike.

Konferenca e shkollës përpunon një program shkollor, i cili përmban pika qëndrore pedagogjike dhe qellime për tre deri në pesë vjetët e ardhshme dhe që aprovohet dhe publikohet nga këshilli ndërmjetësues i shkollës. Në këtë program përfshihen edhe mendi-

met e prindërve dhe fëmijëve të shkollës të përmbledhura në menyrë systematike.

Komentet e prindërve mund të merren pranë grupimit të përgjithshëm bashkrëndues prindëror. Një planifikim vjetor ndihmon që objektivat e programit shkollor të zbatohen rigorozisht.

Çdo katër vjet shkolla vlerësohet nga zyra specifike kantonale për vlerësim. Në këtë kontekst zhvillohen edhe pyetësorë për prindërit.

KOPSHTI I FËMIJËVE BËHET PJESË E SHKOLLËS FILLORE

Që nga 2008-ta kopshti i fëmijëve do të kantonalizohet dhe me këtë bëhet edhe pjesë e shkollës fillore. Kopshti i fëmijëve do të bëhet i detyrueshëm, detyrimi shkollor do rritet nga 9-të në 11 vjet – si rregull dy vjet kopësht fëmijësh, gjashtë vjet cikël i parë dhe tre vjet cikël i dytë. Më tej kjo do të thotë, që rregullimet që vlejné për shkollën fillore do vlejné edhe për kopshtin e fëmijëve.

Të gjithë fëmijët të cilët deri më 30. Prillin e një viti kanë mbushur 4-vjet, fillimi i vitit të tjetër shkollor dhe hyrja në kopësht bëhet për ta i detyrueshëm. Nëse fëmija ka mbushur deri më 31. korrik 4-vjeç dhe për aq sa e tregon edhe niveli zhvillimor i fëmijës, këshilli ndërmjetësues i shkollës mund të lejojë hyrjen e parakohshme në nivelin e kopshtit për fëmijë me fillimin e vitit të tjetër shkollor. Në këtë rast këshilli ndërmjetësues i shkollës dëgjon të pranishmit, merr specialistë në rast nevojë dhe udhëzon futjen e masave të tjera sqaruere.

Gjuha gjatë mësimin në kopësht është pjesërisht gjuha standarte, kurse në ciklin e parë dhe atë të dytë kryesisht vetëm standarte.

MË PAK KLASA TË VEÇANTA, MË TEPËR INTEGRIM

Fëmijë me vështirësi në mësim, por edhe nxënëset dhe nxënësit e talentuar përkrahen aq sa është e mundur brenda klasës përkatëse.

Që në këto ditë shumë komuna të Cyrihut e kanë kthyer pjesërisht ofertën me masa pedagogjike të veçanta në atë integruese. Kjo ka treguar, që integrimi shkollor në krahasim me masat ndarëse pedagogjike të veçanta (Sonderklassen) shfaqet më efektiv.

Nëpërmjet riorganizimit të ofertës pedagogjike të veçantë masat e ndryshme të deritanishme në komuna standartizohen.

Mësuesit në klasa do mbështeten dhe këshillohen nëpërmjet specialistëve të pedagogjisë shëruese. Nga bashkëpunimi i personave të specializuar brenda klasës përfitojnë të gjithë fëmijët po ashtu edhe shkolla forcohet si e tërë. Terapitë ndihmojnë individualisht fëmijët e veçuar në plotësimin e mësimin. Për fëmijë, të cilët nuk mbështeten aq sa duhet në klasat normale ose ato të vogla, komunat garantojnë si më përpara shkollimin e veçantë.

Një mënyrë e re caktimi për masat e veçanta pedagogjike merr parasysh pikëpamjet e të gjithë të përfshirëve (prindërit, mësuesit, drejtorja e shkollës etj.) dhe përforcon përgjegjësinë e përbashkët. Në përcaktimet e rregullta vendore masat kontrollohen mbi nevojshmërinë dhe efektivitetin e tyre.

Që nga viti shkollor 2008/09 shkollat në kantonin e Cyrihut do të klasifikojnë ofertën e tyre për fëmijët me nevoja të veçanta dhe do ja përshtasin ligjit të ri për shkollën fillore.



NË SHKOLLË NGA ORA 8 DERI NË 12

Me ligjin e ri për shkollën fillore do të futen që nga viti shkollor 2007/08 oraret e mësimi bllok në përgjithësi dhe për të gjitha nivelet shkollore. Oraret e mësimi bllok sigurojnë një mësim pa shkëputje ose një mbikqyrje tjetër pa pagesë gjatë të gjithë paradites që nga ora 8 deri në 12. Këto orare të përditshme mësimi ose mbikqyrje mund të shkurtohen sipas arësyeve organizative shkollore në rreth 20 minuta çdo paradite.

Shkolla ka mundësinë të ofrojë oraret bllok me mësim të detyrueshëm ose me mësim të detyrueshëm të plotësuar me kujdestari pa pagesë. Nëse shkolla ofron në kuadër të orareve mësimore bllok edhe kujdestari atëherë këto oferta janë vullnetarisht të frekuentueshme dhe pa pagesë për nxënëset dhe nxënësit.

KUJDESTARIA JASHTË ORARIT SHKOLLOR

Me orët bllok kujdestaria për fëmijet mbulohet gjatë paradites nga shkolla. Komunitat janë nëpërmjet ligjit të ri për shkollat fillore të obliguara, që nga viti 2009/10 të ofrojnë një ofertë kujdestarie plotësuese dhe të përshtatur sipas nevojës (me drekë, strehë ditore ose masdreke). Nevoja duhet të shqyrtohet nga komuna, për shembull nëpërmjet një pyetësori prindëror.

Prindërit bëjnë zgjidhjen së në çfarë ditësh dhe në çfarë kohe (mes ore 7.30 dhe 18) të zgjedhin një kujdestari jashtëshkollor. Për ofertat e kujdestarisë jashtëshkollor komunitat mund të kërkojnë nga prindërit përfshirje në shpenzimet financiare deri maksimalisht në mbulimin e plotë të tyre. Komuna vendos se në ç'formë ndoshta financohen dhe subvencionohen strukturat ditore

ORËT E DETYRAVE

Detyrat e shtëpisë duhet të bëhen në shtëpi. Prindërit janë për këtë të obliguar, tu krijojnë fëmijëve për kryerjen e detyrave kushte të përshtatshme (shiko për këtë „obligimet e prindërve“). Komunitat mund të ofrojnë pa pagesë orë detyrash të mbikqyrura dhe në disa raste të detyrojnë nxënësit të marrin pjesë.

Në ndihmesën për detyrat nuk bëhet fjalë tu sqarohen fëmijëve detyrat, por tu krijojnë fëmijëve kushte të përshtatshme, në mënyrë që ata të kryejnë detyrat në një atmosferë të qetë dhe më çlodhëse.

MUNGESAT NË SHKOLLË

Në parim prindërit mund të nisen nga ajo, që mësimi zhvillohet sipas planit mësimor. Nëse një mësues mungon papritur në klasë, mësuesit e tjerë ose drejtorja shkollorë marrin përsipër fëmijët, derisa të gjendet një zëvendësues («Spetten»). Ndryshimet në planin mësimor (si p.sh. ndërprerja e mësimi të një shkolle për arsye kualifikimi të mësuesve), u komunikohen prindërve në kohë qysh në planin gjysëmvetor ose tremujor.

Komunave u lihet të vendosin, nëse ato në këto raste ofrojnë një kujdestari së paku për kohën e orëve bllok.

DITËT E VIZITAVE DHE NGJARJET E VEÇANTA NË SHKOLLË

Komunitat janë të detyruara, që çdo vit të realizojnë në shkolla së paku dy gjysëm ditë vizitash.

Këto gjysëmditë vizitash dhe ngjarjet shkollorë të veçanta (për shembull dita e mbylljes së një jave projekti, përrurimi i ndërtesës së një shkolle etj.) munden të zhvillohen edhe të shtunave. Gjysëm ditët e vizitave dhe ngjarjet shkollorë të veçanta që bëhen të shtunave, janë për fëmijët e shkollës dhe mësuesit të

obligueshme dhe nuk mund të kompensohen me një ditë tjetër të javës.

MUNGESAT, LEJEDHËNIA DHE DITËT ME FAVORIZIME

Nëse fëmija është i sëmurë ose për arsye tjera të paparashikueshme nuk mund të marrë pjesë në mësim, duhet që prindërit të lajmërojnë menjëherë shkollën. Në rastin kur mungesat janë të parashikueshme, duhet që prindërit të bëjnë kërkesë në kohën e duhur për një leje.

Nëse paraqiten arsye të mjaftueshme atëherë këshilli ndërmjetësues i shkollës mund të japë leje për mosparaqitjen në shkollë. Si arsye të mjaftueshme vlejnjë në veçanti:

- sëmundjet ngjitëse në ambientin personal të nxënësve,
- raste të jashtëzakonshme në ambientin personal të nxënësve,
- festa të rëndësishme apo raste të veçanta të natyrës fetare,
- Përgatitje dhe pjesëmarrje aktive në raste të rëndësishme kulturore dhe sportive,
- nevojë e jashtëzakonshme përkrahjeje e talentëve sportiv dhe kulturor ,
- përgatitje kualifikimi apo raste të ngjashme përgatitjesh për punë.

Të gjitha rregullat mbi lejdhënien dhe mungesat vlejnjë edhe për kopshtin e fëmijëve.

Gjatë dy ditëve (ditët me favorizime/bonus) për çdo vit shkollor nxënëset dhe nxënësit e shkollës mund të mungojnë pa arsye. Ditët me favorizime (Jokertage) janë një bonus pushimi prej dy ditësh ose gjysmë ditësh në vit (të cilat llogariten gjithashtu si ditë të plota). Për ditët me favorizime prindërit nuk kanë nevojë të paraqesin ndonjë kërkesë për leje. Mjafton informimi në kohë nga prindërit, që fëmija i tyre do të mungojë në një ditë të

caktuar. Nëse këshilli ndërmjetësues i shkollës mund të vendosë për bllokim ditësh –ngjarje të veçanta shkollore ose ditë vizitash- atëherë me këtë mendohet, që ditët e favorizuara nuk lejohen të merren në këto ditë.

Përveç kësaj ajo duhet të vendosë, nëse ditët e favorizuara mund të merren edhe të kompaktësuara (kopësht fëmijësh, 1. deri në 3. klasë fillore, 4. deri në 6. klasë fillore dhe cikël i dytë).

VLERËSIMI DHE VENDIMET MBI ECURINË SHKOLLORE

Vlerësimi i një nxënëseje apo nxënësi nuk kufizohet me mesataren e rezultateve të provimeve. Një fëmijë vlerësohet në sajë të kompetencave lëndore (arritjet shkollore), kompetencave sociale (përvojat në familje, në shkollë dhe në ambientin shoqëror) dhe kompetencës individuale (rrethana të kushtëzuara nga zhvillimi, pozicionet dhe gjykimet).

Për promovimin në klasën tjetër, kalimin në nivelin tjetër dhe ndërrimin përbrenda ciklit të lartë, vlen parimisht një procedurë konsensusi. Kjo do të thotë, mësuesit përkatës, drejtorja e shkollës dhe prindërit vendosin së bashku. Në të shumtën e rasteve kalimi në klasën apo nivelin tjetër diskutohet në mes mësuesit dhe prindit.

Nëse nuk arrihet një mendim i përbashkët, përfshihet në bisedimin e ardhshëm edhe drejtorja e shkollës.

Nëse edhe në këtë rast të pranishmit nuk gjejnë një konsensus, aktet i kalohen për vendim këshillit ndërmjetësues të shkollës.

INSTANCAT APELUESE

Ashtu siç u përmend tashmë në mënyra të ndryshme, vlen në të shumtën e rasteve kur prindërit kanë të drejtën e bashkëvendosjes, procedura konsensuale. Nëse prindërit nuk

janë të kënaqur me vendimin, atëherë ata mund të mbërrijnë deri në instancat më të larta. Konkretisht kjo do të thotë: nëse prindërit nuk mund të bien dakort me mësuesin, duhet të përfshihet drejtorja shkollore. Nëse palët prap nuk pajtohen, atëherë vendos këshilli ndërmjetësues i shkollës. Urdhëresat e këshillit ndërmjetësues të shkollës mund të hidhen poshtë me apelim në këshillin e rrethit.

VIZITAT MJEKSORE

Fëmijët e shkollës vizitohen në kopësht dhe në ciklin e lartë nga me shpenzime të komunës.

Kontrolli mjekësor përfshin gjendjen vaksinu-ese, madhësinë, peshën, aftësitë e dëgjimit dhe të pamurit. Në shkollën dytësore, kontrolli mjekësor, sipas dëshirës së nxënëses apo të nxënësit mund që të plotësohet edhe me një bisedë. Në klasën e katërt bëhet vetëm kontrolli i gjendjes vaksinore. Prindërit mundin që sipas dëshirës së tyre kontrollet ti bëjnë te ndonjë mjek privat.

Në këtë rast ato i marrin shpenzimet vetë përsipër. Në qoftë se komuna tërhiqet nga organizimi i kontrollit mjekësor, atëherë ajo u mbulon prindërve shpenzimet e duhura. Prindërit janë atëherë të detyruar që kontrollet ti bëjnë te një mjeke apo mjek privat.

SHKOLLAT PRIVATE DHE MËSIMI PRIVAT

Shkollimi i detyruar mund të përmbushet me ndjekjen e një shkolle shtetërore apo private ose nëpërmjet mësimi privat në shtëpi (Homeschooling). Shkollave private u nevojitet një aprovim nga drejtorja arsimore.

Si mësim privat vlen mësimi individual dhe mësimi në një grup prej maksimalisht pesë nxënësesh dhe nxënësis. Për këtë mësim nuk nevojitet ndonjë aprovim por si për shkollën private duhet që qëllimet e mësimi

të realizohen sipas planit mësimor të Cyrihut. Në qoftë se mësimi privat zgjat më shumë se një vit, atëherë ai mund të jepet vetëm nga një mësues i kualifikuar.

Nëse prindërit vendosin që fëmijën e tyre ta dërgojnë në një shkollë private, atëherë duhet që ata ti marrin vetë përsipër shpenzimet që lidhen me të (pagesa e shkollës dhe shpenzimet sekondare sipas kontratës së shkollës). Sigurisht ju keni të drejtë edhe për disa ndihma nga shteti.

Kështu të gjitha mjetet mësimore të konsideruara nga këshilli arsimor si të detyrueshme, ju mund ti merrni falas. Për marrjen e këtyre ndihmave prindërit duhet ti drejtohen këshillit ndërmjetësues të shkollës të rrethit ku ata banojnë.

Fëmijët e shkollave private kanë të drejtë për terapi falas njëjloj si nxënëset dhe nxënësit e shkollave fillore shtetërore. Po ashtu falas janë edhe sqarimet e domosdoshme logopedike, psikologjiko shkollore etj. Se cila terapi dhe në çfarë përmase ajo duhet të bëhet, per këtë vendosën këshilli ndërmjetësues i shkollës.

